



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242255
Datë: 06.03.2025
Numri i dokumentit: 06948456

Ac.nr.3277/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Adnan Konushevc, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B., tani në Likuidim, me seli në Prishtinë, rruga “T”, nr.**/*, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R.K, kundër të paditurit A.J nga fshati M, Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nebi Troshupa, avokat në Lipjan, për kthimin e borxhit në emër të kredisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/14 i datës 21.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit A.J nga fshati M, Komuna e Suharekës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/14 i datës 21.02.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.****/14 i datës 21.02.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses B. në Likuidim, me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin A.J nga fshati M, Komuna e Suharekës, t’ ja paguaj paditëses në emër të kredisë së pa kthyer për borxh kryesor shumë prej 274,000.00€, si dhe për kamatën e rregullt të kontraktuar shumë prej 23,000.00€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 297,000.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Në pikën II (dy) ka vendosur që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore , konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe padia e paditëses të hedhet poshtë apo lënda t'i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e ushtruar nga i padituri, ka paraqitur paditësja nëpërmes likuidatorit të bankës, me të cilën i kanë kundërshtuar pretendimet ankimore të t 'paditurit me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se: *Ankesa e të paditurit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja B., me seli në Prishtinë, tani në Likuidim, me datë 07.06.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit A.J nga fshati M, Komuna e Suharekës- pronar N.T. "A.", me seli në Suharekë, për kthimin e borxhit të marr në emër të kredisë, e më gjerësisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.****/14 i datës 21.02.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se palët kanë lidhur kontratë për kredi revaluuese dhe as fakti se i padituri ka përmbushur një pjesë të borxhit, mirëpo kontestuese ishte vlera e mbetur e borxhit për pagesë – lartësia dhe nëse kërkesa është e parashkruar.

Mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar se në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësja dhe i padituri me datë 19.09.2004 kanë lidhur kontratën me Nr.****/2004 për kredinë revaluuese, në vlerë prej 400,000.00€, me të cilën kontratë banka i ka akorduar kredi revaluuese të paditurit – huamarrësit me shfrytëzim të disa hershëm me afat kohore prej 12 muajve, deri në shumën e limituar të kredisë prej 400,000.00€. Me anë të kontratës i padituri – kredimarrësi është obliguar që në rast se vonohet në ndonjë këst të pagesës së pjesës së mëparshme të shfrytëzuar të limitit, të njëjtit mund të mos i lejohet shfrytëzimi i pjesës tjetër të limitit të mbetur në afatin e përcaktuar me kontratë, e që është afati prej 12 muajve. Ka arsyetuar se nga kontrata e lidhur në mes të atje palëve kontraktuese këtu ndërgjyqëse dhe në

bazë të deklaratimit të vetë të paditurit në deklaratën e datës 03.06.2009, është vërtetuar se vlera e marrë - tërhequr në emër të kredisë nga ana e të paditurit ka qenë në shumë prej 400,000.00€, me normë mujore të interesit prej 1.2%, e cila është llogaritur për çdo ditë pune, për çdo shumë të lejuar pjesërisht që nga dita e shfrytëzimit të mjeteve. Gjykata më tej ka arsyetuar se nga provat e administruara ka gjetur se vlera totale e kredisë për pagesë ka qenë në shumë prej 512,011.00€ (shumë e cila përfshinë borxhin kryesor dhe kamatën e rregullt), ndërsa i padituri ka paguar shumën prej 215,000.00€, dhe atë borxh kryesor 126,000.00€ dhe kamatë të rregullt 89,000.00€, ashtu që pagesa e fundit në emër të kredisë revaluase është bërë me datë 23.09.2009, në vlerë prej 28,000.00€, ndërsa pas kësaj date i padituri nuk ka përmbushur asnjë obligim të kredisë të cilën e ka pasur ndaj paditëses, andaj në këtë mënyrë ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimeve të arritura për pagesë, për çka i padituri si rezultat i mos përmbushjes së detyrimit kontraktues – marrëveshjes së kredisë revaluase ka për detyrim që paditëses në emër të kredisë së pa kthyer t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 297,000.00€, përfshirë borxhin kryesor dhe kamatën e rregullt – kontraktuar. Lartësinë e kërkesës gjykata e ka bazuar në ekspertizën financiare të punuar nga ekspertja A.G, të cilën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, të cilës edhe i ka falur besimin, nga e cila ka rezultuar se vlera e kredisë ka qenë në shumë prej 400,000.00€ dhe kamata në shumë prej 112,000.00€, e në total shuma e tërësishme prej 512,000.00€; nga kjo pjesë është paguar shuma prej 215,000.00€, ndërsa si vlerë e mbetur për pagesë del shuma prej 297,000.00€. Në fund gjykata ka arsyetuar se nga gjendja e vërtetuar faktike ka gjetur se kontrata me Nr.*****/2004 për kredinë revaluase, ka krijuar të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese pasi që me kontratën e lartcekura palët kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet reciproke, siç është paraparë me nenin 148 paragrafi 1 i LMD-së. Andaj duke marrë për bazë faktin se kreditë revaluase janë kredi financiare dhe mund të shfrytëzohen shumëfish brenda një afati të caktuar kohor dhe deri në limitin e caktuar, janë të tilla që mundësojnë përsëritjen automatike pas shfrytëzimit të kredisë deri në limitin e caktuar, të cilin ia mundëson kredi dhënësi, çka në rastin konkret paditësja në cilësi të kreditorit i ka të gjitha autorizimet që të kërkoj nga i padituri/debitori përmbushjen e detyrimeve siç edhe e kanë paraparë me kontratë, me ndërgjegje sikurse është përmbajtja e tij konform nenit 262 paragrafi 1 të LMD-së.

Përkitazi me pretendimin e të paditurit se kërkesa është parashkruar, gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar si të pa bazuar me arsyetimin se në rastin konkret vlen afati i përgjithshëm i parashkrimit ngase lidhur me kërkesat që rrjedhin nga kontrata e kredisë (huasë) nuk është paraparë afat i veçantë i parashkrimit, andaj në rastin konkret zbatohet dispozita e nenit 371 të LMD-së, e cila parasheh se: “*Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit*”. Në kuptim të kësaj dispozite duke pasur parasysh se detyrimi është krijuar me datë 17.09.2004 dhe pagesa e fundit është bërë me datë 23.11.2009, ndërsa i padituri me datë 23.06.2009 ka paraqitur deklaratë me shkrim tek paditësja, ku e ka pohuar borxhin që e ka ndaj bankës dhe ka shprehur gatishmërinë që ta likuideoj, gjykata e ka vlerësuar se me këto veprime të të paditurit është ndërprerë parashkrimi duke filluar rishtas rrjedhja e afatit të parashkrimit, e kjo duke ju referuar dispozitës së nenit 387 të LMD-së. Në fund ka theksuar se mbi këtë bazë rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor, konkretisht nga data 23.11.2009 kur është bërë pagesa e fundit dhe paraqitja e padisë me datë 07.06.2013 nuk kanë kaluar 5 vite.

Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështet në dispozitën ligjore të nenit 463 par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t' paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia për përmbushjen e borxhit në emër të kredisë së pa kthyer e poashtu dhe lartësinë. Përveç të cekurave arsyetimi i aktgjykimit përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të t'paditurit për shkelje të dispozitave nga neni 182.2 pika e) të LPK-ës, me pretendimin se gjykata ka vepruar sipas padisë kërkesa e të cilës është parashkruar, për faktin se këto pretendime janë paraqitur nga pala e paditur edhe në seancat e mbajtura gjyqësore për të cilat gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye në aktgjykimin e ankimuar e me të cilat qëndrime dhe vlerësime të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, e që rrjedhimisht nuk qëndron shkelja e dispozitës së pretenduar nga i padituri.

Të pabazuara qëndrojnë edhe pretendimet e të paditurit për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur me çështjen kontestuese në fjalë, qoftë sa i përket të provuarit të themelësisë së kërkesëpadisë por edhe lartësisë së saj, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr tek ajo gjykatë, e cila gjendje faktike e vërtetuar dhe konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit, pasi që kjo gjykatë vlerëson se ka mbështetje të plotë në provat shkresore.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, qartë konstatohet se paditësja dhe i padituri me datë 19.09.2004 kanë lidhur kontratën për kredinë revaluuese me afat kohore prej 12 muajve, deri në shumën e limituar të kredisë prej 400,000.00€, të cilën shumë i padituri e ka tërhequr në emër të kredisë, me normë mujore të interesit prej 1.2%, e cila është

Ilogaritur për çdo ditë pune, për çdo shumë të lejuar pjesërisht që nga dita e shfrytëzimit të mjeteve. Ka vërtetuar poashtu faktin se vlera totale e kredisë për pagesë ka qenë në shumë prej 512,011.00€ (shumë e cila përfshinë borxhin kryesor dhe kamatën e rregullt), ndërsa i padituri ka paguar shumën prej 215,000.00€, dhe atë borxh kryesor 126,000.00€ dhe kamatë të rregullt 89,000.00€, dhe se pagesa e fundit në emër të kredisë nga i padituri është bërë me datë 23.09.2009, në vlerë prej 28,000.00€, ndërsa pas kësaj date i padituri nuk ka përmbushur asnjë obligim të kredisë të cilën e ka pasur ndaj paditëses, kështu duke rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimeve të arritura në shumën e përgjithshme prej 297,000.00€ dhe atë për borxh kryesor shumën prej 274,000.00€, si dhe për kamatën e rregullt të kontraktuar shumën prej 23,000.00€. Lartësinë e borxhit në emër të kredisë së pa paguar nga ana e të paditurit gjykata e ka bazuar në ekspertizën financiare të punuar nga ekspertja A.G, të cilës edhe i ka falur besimin dhe e ka pranuar në tërësi si të besueshme, e si të tillë e vlerëson edhe kolegji i kësaj gjykate, andaj vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 148 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD i vitit 1978) i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil në mes të palëve ndërgjyqëse përcaktohet se: ”Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese”, ndërsa me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 parashihet se: ”Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike.

Rrjedhimisht janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të t ‘paditurit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale me pretendimin se kërkesa e padisë është parashkruar dhe se gabimisht është zbatuar dispozita e nenit 371 të LMD-së me rastin e llogaritjes së afatit të parashkrimit dhe se sipas të paditurit në këtë rast gjen zbatim dispozita e nenit 372 të LMD-së , ngase kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret në mes palëve ndërgjyqëse ekziston raporti kontraktues për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e kredisë (huasë) për të cilat kontrata me ligj nuk është paraparë afat i veçantë i parashkrimit, e jo për kërkesa të dhënieve periodike, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka zbatuar dispozitën e nenit 371 të LMD-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil në mes të këtu palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet ankimore për “zbatim të gabuar të dispozitave ligjore nga neni 349 dhe 355 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

Ligji nr. 04/L-077” , mirëpo kjo gjykatë nuk u lëshua fare në vlerësimin e këtyre pretendimeve ngase këto dispozita nuk janë zbatuar fare nga gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ngase ky ligj nuk ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil, andaj rrjedhimisht edhe nuk ka zbatim të gabuar të këtyre dispozitave të pretenduara ligjore.

Pretendimet ankimore të t ‘paditurit me referim në dispozitën ligjore të nenit 262 dhe 357 të LPK-së janë konfuze dhe të paqarta, për faktin se një pretendim i tillë është paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar pa specifikuar se ku konsiston një pretendim i tillë ankimor në lidhmëri me çështjen kontestuese dhe vendosjen me aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo i vlerësoi si të pabazuara për faktin se këto pretendime janë paraqitur nga i padituri edhe në seancat e mbajtura gjyqësore për të cilat gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të detajuara në aktgjykimin e ankimuar e me të cilat qëndrime dhe vlerësime të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3277/22, me datë 28.02.2025.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.